REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR**
**DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE**
**SEKTORI I FINANCES**

**Nr** 1214 **prot** **Ballsh,më** 20 / 03 **2024**

**PROJEKT VENDIM**

**Nr** 12 **Datë** 20 / 03 **2024**

**PËR RISHPËRNDARJE TË FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN 2024**

Mbeshtetur ne nenet 34,40,41, 55 te ligjit Nr 139/2015 "Per Vetëqeverisjen vendore",ligjin Nr 9936 date 26-08-2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise",te ndryshuar,kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29,kreu VII nenet 39-40 te ligjit Nr 68/2017 "Per Financat e Vetqeverisjes Vendore",Ligjin Nr 97/2023"Per Buxhetin e Vitit 2024"ligjin Nr 10296 date 08-07-2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",dhe VKB nr.64 datë 21.12.2023 "**Për miratimin e numrit të përgjithshëm te punonjësve dhe buxhetit të vitit 2024** si dhe shkresës me nr.1815/3 prot. datë 11.03.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me lëndë " Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit hde Sportit,për objkete shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin"kryetari i Bashkisë,i propozon këshillit te Bashkise Mallakaster:

**TË MIRATOJ**

1. **Rishpërndarja e fondeve buxhetore si më poshtë:**

| Entiteti I Qeverisjes | Ministria e Linjes | Kodi I institucionit | Kapitull | Programi | Nr Llogarise | Shuma | Emërtimi i projektit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **PAKSOHET** | | | |
| 131 | 00 | 2131012 | 05 | 04520 | 6020000 | 2 968 745 | Materiale te ndryshme , Cakull, stabilizant, steril bituminoz per mirmbajtje rruge ne fshatra |
| | | **SHUMA** | | | | **2.968.745** | |
| | | | | **SHTOHET** | | | |
| 131 | 00 | 2131001 | 05 | 09120 | 2310000 | 2 968 745 | Mbikqyrje punimesh në objektin "Ndërtim i shkollës "Gjok Doçi " |
| | | **SHUMA** | | | | **2 968 745** | |

Drejtori Drejtorise Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale mbeshtetese
Aleksander Rama

Drejtor i Drejtorise se Buriumeve Njerezore ,Juridike dhe funksioneve
Laureta Saliaj

**KRYETAR**
**Qerim ISMAILAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA MALLAKASTËR
## DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE
## SEKTORI I FINANCES

Nr 1214 prot  Ballsh,më 20.03 2024

# RELACION
# PËR

## PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN 2024.

Bashkia Mallakastër pas aplikimit për projektet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për objektet shkollore është shpallur fitues për projektin "Ndërtim i shkollës Gjok Doçi".
Sipas shkresës me nr.1815/3 prot. datë 11.03.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me lëndë " Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit hde Sportit,për objkete shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin", vlera totale e projektit të këtij objekti është 190.613.399 (Njëqind e nëntëdhjetë milionë e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë ) lekë ,e ndarë pë financim në 2(dy) vite 2024 dhe 2025 .
Financimi i këtij projekti do të bëhet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në shumën 162.021.389 (Njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e njëzetë enjë mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë e ndarë në 2 (dy) vite:

- Viti 2024 - 45.000.000 lekë
- Viti 2025 - 117.021.389 lekë

Dhe nga buxheti i Bashkisë Mallakastër në shumën 28.592.010 (Njëzetë e tetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë dy mijë e 10 ) lekë,e ndarë në dy vite:

- Viti 2024 - 17.000.000 lekë
- Viti 2025 - 11.592.010 lekë

Për zbatimin e projektit "Ndërtim i shkollës Gjok Doçi" nga përllogaritja e fondit për Mbikqyrje punimesh në objektin "Ndërtim i shkollës Gjok Doçi" duhen 2.968.745 (Dymilionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dyzetë e pesë) lekë. .Pë realizimin e kësaj procedure prpozohet që të bëhen rishpërndarjen e fondeve buxhetore si më poshtë:
**Pakësohet** me **2.968.745** lekë zëri buxhetor Materiale te ndryshme , Cakull, stabilizant, steril bituminoz per mirmbajtje rruge ne fshatra :
**Shtohet** me **2.968.745** lekë zëri buxhetor : Ndërtim i shkollës Gjok Doçi

Drejtori Drejtorise Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale
Aleksander Rama

**KRYETAR**
**Qerim ISMAILAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALLAKASTËR